



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.nr.514/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të masës së sigurimit Botek shpk NUI:810356081 me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson V.V. avokat në Prishtinë, kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Agjencia Qendrore e Prokurimit në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Z.M.G. nga Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.841/2023 i datës 14.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit të masës së sigurimit Botek shpk me seli në Prishtinë, dhe VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, K.E.nr.841/2023 i datës 14.12.2023

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KE.nr.1841/23 dt.14.12.2023, ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit Botek shpk me seli në Prishtinë, kundër kundërshtarit të sigurimit Agjencia Qendrore e Prokurimit në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që ti ndalohe kundërshtarit të masës së sigurimit ekzekutimi i vendimit për ndërprerjen e kontratës me numer protok,95/23 datës 05.10.2023, si dhe ti ndalohe kundërshtarit të masës së sigurimit ndermarrja e qfardo veprimi në drejtim të mos zbatimit të kontratës publike për furnizim me tablet për nevojat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me numer prokurimit UA/2016-23-6181-1-1-1, numri i kontratës UA-2016-23-6181-1-1-1/C365 numër protokoli 72/23.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i propozuesit të sigurimit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të Aprovohet në tërsi ankesa e propozuesit të sigurimit si e bazuar, aktvendimin e atakuar të Ndryshohet duke e Aprovuar në tërsi si

të bazuar propozimin e propozuesit për lëshimin e masës së sigurimit apo ankesën ta aprovoj, aktvendimin e atakuar ta prish dhe lëndën ta kthen në rivendosje.

Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi i masës së sigurimit Botek shpk me seli në Prishtinë, pranë Gjykatës, me datën 30.10.2023, ka paraqit padi kundër të paditues Agjencia Qendore e prokurimit në Prishtinë, për shkak të mos përmbushjes së kontratës me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, kundër të paditurit të sigurimit, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurisë dhe ti ndalohej kundërshtarit të sigurimit, ekzekutimi i vendimit mbi ndërprerjen e kontratës të paditues dt.05.10.2023 numër protokollit 95/23, dhe ti ndalohej kundërpropozuesit të marrë çfardo veprimi në drejtim të mos zbatimit të kontratës me titull Kontratë publike për furnizim me tablet për nevojat e Agjencise së Statistikave të Kosovës numër prokurimit UA/2016-23-6181-1-1-1, numri i kontratës UA-2016-23-6181-1-1-1/C365 numer protokoli 72/23 deri në plotfuqishmërin e aktgjykimit.

Dhoma e shkallës së parë ka mbajtur seancën dëgjimore me datë 14.12.2023, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe lidhur me propozimin e masës së sigurimit, ka marrë Aktvendimin KE.nr.841/2023 datë 14.12.2023, me të cilin e ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit të sigurimit duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të këtij vendimi, Dhoma e shkallës së parë referohet në dispozitat e nenit 297.1 të LPK-së, dhe se në rastin konkret vleron se nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit. Gjykata vleroi se nuk ekziston asnjë rrezik që paditësi në të ardhmen të mos mund të realizoj kërkesën e tij, për faktin se si palë e paditur rezultoi të jetë organi shtetëror i cili nuk mund të shuhet as ti nënshtrohet ndonjë procedure të falimentimit nga e cila do të rrezikohej realizimi i kërkesës së propozuesit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Dhomës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së, sikurse pretendohet në ankes, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e

kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besueshëm faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së saj. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se kemi të bëjmë me një vendim të paditurës për ndërprerjen e kontratës nr.95/23 datës 05.10.2023 me titull “ furnizim me tablet për nevojat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nr. prok. UA/2016-23-6181-1-1-1, për shkak të dështimit në liferimin e mallit me kohë dhe specifikave teknike të kërkuara.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se dhoma e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 182 par.2 pika (n) e LPK-së, se aktvendimi i atakuar është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetëvete. Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Kolegji konstaton se në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, në mënyrë të qartë janë dhënë kushtet ligjore që duhet përmbushur për caktimin e masës së sigurimit dhe në anën tjetër janë dhënë arsye të mjaftueshme sa i përket besueshmërisë së ekzistimit të kërkesës për të vendosur në caktimin e masës së sigurimit në vështrim të nenit 297 pika a) dhe b) të LPK-së.

Përfundimisht, Dhomat e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e shkallës së parë, pasi që Dhoma e shkallës së parë, i ka vlerësuar vetëm rrethanat nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive, dhe në këtë rast nuk mund të ndikohet çështja kryesore në vlersimin e pretendimeve për kundërligjshmerinë e paditues në shkëputjen e njëanshme të kontratës e cila është objekt i kërkespadsisë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë, konsideron se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, që të caktohet masa e sigurimit.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të aktgjykimit në bazë të nenit 195.1 nën pikën d) e lidhur me nenin 209 par.1 nën pikën b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.514/24 datë 06.03.2024

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari

Krenar Berisha